

VENDIM
Nr.121, datë 3.2.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA KASTRIOT TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Kastriot të qarkut të Dibrës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë e që përfundon me numrin rendor 7 (shtatë) dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Kastriot për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2. FORMULAR I LISTES PERFUNDIMTARE TE PRONAVE TE PALUAJTESHME SHETERORE (sipas inventarizimit te pronave te vecanta te tipit pyje, kullota, livadhe, shkembore, etj.)

Institucioni i Pushtetit Qendror: M.M.P.A.U.									
Komuna: Kastriot									
Nr. i prones sipas VKM	Emertesa e ekonomise pyjore dhe kullosore (PPK) Shtrirja gjeografike PPK	Emertesa e ngastres Vendndodhja (sipas emerteses popullore)	Numri i ngastres	Destinacioni	Siperfaqja ne ha	Funksioni per te cilen perdoret prona	Institucioni me pergjegesi administrative	Institucioni / Enti perdoresh Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
104	EP Kastriot - Silove	Veçit	245	Pyll	26,25	Mbrojtjes	M.M.P.A.U.	D.S.H.P. Diber	
105	EP Kastriot - Silove		246	Pyll	4,00	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.S.H.P. Diber	
106	EP Kastriot - Silove		247	Pyll	14,25	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.S.H.P. Diber	
107	EP Kastriot - Silove	Zbineci	248	Pyll	39,50	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.S.H.P. Diber	
108	EP Kastriot - Silove	Zbineci	249/a	Pyll	17,25	Mbrojtjes	M.M.P.A.U.	D.S.H.P. Diber	
109	EP Kastriot - Silove	Bregu i Drinit	250	Pyll	47,25	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.S.H.P. Diber	
110	EP Kastriot - Silove	Përroi i Botës	251	Pyll	15,00	Mbrojtjes	M.M.P.A.U.	D.S.H.P. Diber	

Njësia e Qeverisjes Vendore Komuna Kastriot

Lidhja 1

[illegible]